



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.67/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë, kundër debitorit S.S. Mozaik me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1207/22 të datës 09.10.2023, me datë 04.03.2024, mori këtë

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1207/22 i datës 09.10.2023, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit S.S. Mozaik me seli në Prishtinë i ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.24/21 datës 05.01.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Bardh Tasholli, dhe Mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.24/21 i datës 05.01.2021 i lejuar nga përmbaruesi privat Bardh Tasholli.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1207/22 të datës 09.10.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit S.S. Mozaik me seli në Prishtinë dhe ka anuluar Urdhrit Përmbarimor P.nr.24/21 të datës 05.01.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Bardh Tasholli me seli në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.1207/22 i datës 09.10.2024 të anulohet dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ose ta ndryshoj aktvendimin e shkallës së parë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit me arsyetimin se propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet për përmbarim

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetlësi “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë, me datën 31.12.2020 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit S.S. Mozaik me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit, përkatësisht kartelës financiare të konsumatorit me shifër 131673, në shumë të përgjithshme prej 650.07€.

Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetlësi “Prishtina” Sh.A me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr.24/21 të datës 05.01.2021 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit nga librat e Kontabilitetit, përkatësisht kartelës financiare të konsumatorit me shifër 131673, me të cilin ka obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 650.07€, si dhe shpenzimet përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbartuesit Privat, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në xhirollogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit Nr.....-TEB, ose nëse debitori nuk ka mjete në xhirollogarinë e tij, me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësim të ushtruar kundër urdhrin përmbartimor thekson se gjendja faktike nuk është vlerësuar dhe nuk është vërtetuar drejtë, sepse me të gjitha faktet dhe provat vërtetohet se kreditorit nuk i ka borxh shumë e cekur, sepse në bazë të kartelës së konsumatorit konstatohet se ka bërë pagesa herë pas here, si dhe propozimi për përmbartim është i mangët dhe nuk konstatohet se për cilën periudhë kohore po kërkohet vlera e borxhit, por është vetëm paushall. Tutje debitori ka shtuar se është arritur edhe parashkrimi për kërkimin e borxhit konform dispozitave të LMD-së, ku kjo kërkesë e kreditorit parashkruhet në afat prej 1 viti, për arsye se sipas kartelës së konsumatorit po figuron se borxhi është i vitit 2013.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, të pa argumentuar si dhe pa mbështetje në ligj dhe prova. Tutje ka theksuar se parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin, dhe se pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e debitorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë sikurse janë pagesa e këstit, pagesa dhënia e sigurimit. Gjithashtu e ka kundërshtuar deklarinimin e debitorit lidhur me parashkrimin pasi që debitori ka pranuar borxhin e tij dhe njëkohësisht ka bërë pagesa të pjesshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1207/22 datës 09.10.2023 me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit S.S. Mozaik me seli në Prishtinë dhe ka anuluar Urdhrin

Përmbardimor P.nr.24/21, të datës 05.01.2021, të lejuar nga Përmbarduesi Privat Bardh Tasholli me seli në Ferizaj.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar dhoma e shkallës së parë ka theksuar se kartela financiare e Konsumatorit me shifër 131673, në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i pranueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk përmban në mënyrë të qartë, të dhënat e nevojshme për përmbardim, respektivisht periudhën kohore. Nga Kartela Financiare e Konsumatorit e bashkëngjitur sipas shifrës 131673, rezulton se borxhi në shumën prej 670.07 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 29.12.2020, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 31.12.2013, me ç ‘rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhomat e shkallës së dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 29, 37 dhe nenin 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbardimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përmbardimit.

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti - Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër 131673, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbardimore, është dokument përmbardues dhe i përshtatshëm për përmbardim, për faktin se kartela financiare është lëshuar për periudhën 01.01.2013 deri 29.12.2020, në vlerë totale të borxhit 650.07€, andaj kartela financiare, është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbardim, si dhe i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Dhoma e shkallës së dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e dhomës së shkallës së parë se kartela financiare e kreditorit në bazë të cilit është lejuar urdhri për përmbardim, nuk është dokument i besueshëm nga neni 29 paragrafi 1 të LPP-së. Kjo gjykatë vlerëson se dispozitat ligjore

të lartcekura kartelën financiare në këtë rast të kreditorit, e përfshijnë si dokument të besueshëm në bazë të cilit realizohet përmbarimi, pasi që edhe kartela financiare për periudhën 01.01.2013-29.12.2020 e kreditorit, duhet trajtuar si dokument publik, që është ekstrakt, evidencë e kreditorit për klientët, që paraqet gjendjen e debi-kredisë së klientit, në pagimin e borxhit në këtë rast për periudhën 01.01.2013-29.12.2020.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.24/21 datës 05.01.2021 i lejuar nga ana e Përmbaruesit Bardh Tasholli në Ferizaj.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.67/24 dt. 04.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha